



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 24 shkurt, Trupi Gjykses nxori vendim mbi zhvillimin e gjykimit. Në Vendim, gjykatësit përcaktuan se Prokuroria do të ketë 53 orë e gjysmë për të paraqitur provat e veta. Prokuroria synon të mbështetet në 19 dëshmitarë, 14 prej të cilëve pritet që të dëshmojnë në sallën e gjyqit.

Mbrojtjes do t'i jepet i njëjti numër orësh për t'i bërë pyetjet e saj secilit dëshmitar, sa ka përdorur edhe Prokuroria për të pyetur të njëjtin dëshmitar. Mbrojtësit të viktimave do t'i jepet 25% e kohës që do të përdorë faktikisht Prokuroria për të pyetur dëshmitarin përkatës.

Në Vendim, Trupi Gjykses gjithashtu bëri disa ndryshime në datat e planifikuara për seanca për majin dhe qershorin. Datat më të fundit të planifikuara për seancat publike, për të gjitha çështjet gjyqësore të DHSK-së, gjenden në kalendarin e Gjykatës në faqen e internetit.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykses nxori vendim mbi rregullat për njohjen e dëshmitarëve me sallën e gjyqit përpara dhënies së dëshmisë.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, më 27 shkurt, Prokurori i Specializuar dorëzoi version publik me më pak redaktime të Aktakuzës së ndryshuar, që gjendet në faqen tonë të internetit.

Sipas Ligjit dhe Rregullores së DHSK-së, të akuzuarit kanë të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik. Në bazë të këtij parimi, aktakuzat e konfirmuara janë publike, por mund të përmbajnë redaktime, kur është e nevojshme, për shembull për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Në kuadër të parimit të gjykimit publik, parashtimet e protokolluara konfidenciale, përfshirë aktakuzat e redaktuara, rishikohen rregullisht dhe redaktimet mund të hiqen, pas një analizë të kujdesshme dhe rast pas rasti, kurdoherë që arsyeja fillestare që përlligji redaktimin nuk qëndron më.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

